

VENDIM

Nr.289, datë 28.4.2010

PËR SHPALLJEN "PARK KOMBËTAR" TË EKOSISTEMIT NATYROR DETAR PRANË GADISHULLIT TË KARABURUNIT DHE ISHULLIT TË SAZANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 1 shkronja "b", 6 e 13 të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura", të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e ekosistemit natyror detar, pranë gadishullit të Karaburunit dhe ishullit të Sazanit "Park Kombëtar", sipas hartës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Sipërfaqja e përgjithshme e "Parkut Kombëtar" Karaburun-Sazan është 12 570.82 (dymbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë pikë tetëdhjetë e dy) ha, ndarë si më poshtë vijon:

2.1 Pjesa detare pranë gadishullit të Karaburunit ka sipërfaqe 9 848.95 (nëntë mijë e tetëqind e dyzet e tetë pikë nëntëdhjetë e pesë) ha, me kufijtë e mëposhtëm:

a) Veri: Pika 1 (në det), me largësi 1 milje detare (1852 m) nga kepi i Gjuhëzës, me koordinata 4353018.48 V e 4478005.72 L, deri te pika 2 (në det), me largësi 1 milje detare (1852m) nga kepi i Shën Vasilit, me koordinata 4363780.19 V e 4477378.71 L;

b) Lindje: Pika 2 (në det), me largësi 1 milje detare (1852 m) nga kepi i Shën Vasilit, me koordinata 4363780.19 V e 4477378.71 L dhe më pas vijon përgjatë vijës bregdetare nga kepi i Shën Vasilit, kepi i Dhim Kushtës, kepi dhe gjiri i Shën Janit, kepi i Gjuhëzës, ndjek vijën bregdetare perëndimore të malit të Karaburunit, bregun e Gjinarës, faqen e Bishtit të Malit, Rrëzën e Kanalit, faqen e Langadhës deri te pika 3, me koordinata 4379221.15 V e 4449696.28 L.

c) Jug: Pika 3, me koordinata 4379221.15 V e 4449696.28 L, deri te pika 4 (në det), me largësi 1 milje detare (1852 m) nga faqja e Langadhës, me koordinata 4378104.94 e 4448193.75 L.

ç) Perëndim: Pika 4 (në det), me largësi 1 milje detare (1852 m) nga faqja e Langadhës, me koordinata 4378104.94 e 4448193.75 L dhe ndjek izobatin deri te pika 1 (në det), me largësi 1 milje detare (1852 m) nga kepi i Gjuhëzës, me koordinata 4353018.48 V e 4478005.72 L.

2.2 Pjesa detare pranë ishullit të Sazanit ka sipërfaqe 2 721.87 (dy mijë e shtatëqind e njëzet e një pikë tetëdhjetë e shtatë) ha, me kufijtë e mëposhtëm:

Pika 1, me koordinata 4354004.14 V e 4487718.40 L;

Pika 2, me koordinata 4355536.33 V e 4486707.03 L;

Pika 3, me koordinata 4351587.21 V e 4485140.06 L;

Pika 4, me koordinata 4357134.42 V e 4486668.09 L;

Pika 5, me koordinata 4355142.57 V e 4486658.75 L.

3. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministrinë e Mbrojtjes (Roja Bregdetare) dhe institucionet kërkimore-shkencore, merr masa për të siguruar ruajtjen, monitorimin dhe zhvillimin e ekoturizmit nënutor, në "Parkun Kombëtar" Karaburun-Sazan.

4. Administrata ekzistuese e zonës së mbrojtur Llogara-Karaburun kryen dhe funksionet e administratës së "Parkut Kombëtar" Karaburun-Sazan. Administrata e zonës së mbrojtur në ushtrimin e funksioneve bashkëpunon me strukturat përkatëse për zbatimin e

dispozitave të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar dhe të ligjit "Për mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike".

5. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe sipas përkatësisë, ministritë e linjës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

